

RELACION TEKNIK

PROJEKT RESTAURIMI

I Kishës së Ungjillizimit në Kozare - Kuçovë,
Monument Kulture Kategoria I-rë

Berat 2023

I



PËRMBAJTJA E PROJEKTIT:

1. VENDNDODHJA	3
2. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK.....	4
3. PROBLEMATIKAT.....	7
4. NDËRHÝRJET E RESTAURIMIT.....	6

Berat 2023

RELACION

*Mbi punimet restauruese që do të kryen në Kishën e Ungjillizimit në Kozare - Kuçovë,
monument kulture kategoria e parë*

1. VENDNDODHJA

Kisha e Ungjillizimit ndodhet në fshatin Kozare të rrëthit Kuçovë, rrëth 10 km larg (me rrugë automobilistike) nga qyteti i Kuçovës. Kisha është e pozicinuar në majë të një kodre, lehtësisht e arritshme me automjet. Territori i saj është i rrëthuar me kangjella dhe hyrja ndodhet në qoshen jugore.



Foto 1: Vendndodhja e Kishës së Ungjillizimit në Kozare - Kuçovë

2. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK


Kompozimi planimetrik e volumor

PËRSHKRIMI I KISHËS PARA DJEGIES

Kisha e Kozares i përket nëngrupit të bazilikave me tavan të rrafshët. Ajo përbëhet nga naosi me përmasa $955\text{ m} \times 1569\text{ m}$, hajati që e rrethon naosin në tre anë (veri, jug, perëndim) dhe këmbanarja e cila ndodhet pranë hyrjes në krahun jugor. Hapësira e naosit është e mbuluar me çati me strukturë druri dy-ujëse me tjegulla vendi. Hajati në faqen perëndimore mbulohet me çati me strukturë druri tre-ujëse ndërsa pjesa tjeter e hajatit, në faqet veriore dhe jugore janë mbuluar me çati me strukturë druri një-ujëse me tjegulla. Përsa i përket formulimit planimetrik kisha ka në fasadën lindore vetëm një absidë me planimetri gjysmë-rrethore e cila në faqen e jashtme është e dekoruar me 9 harqe të verbër strukturoër dhe të jep përshtypjen se është 9-faqëshe.

Hapësira e brendshme e naosit ndahet në tre nefë nëpërmjet dy rreshtash kolonash druri me seksion katror. Kolonat nuk lidhen me njera tjetrën me harkada por lidhen drejtpërdrejt me trarët e strukturës së çatisë. Për ndarjen e hapësirës në tre nefë shërbejnë dhe dy rreshta stolash druri dyfishe. Dy nefet anësore janë më të ngushta se nefi qendror. I gjithë naosi mbulohet me tavan druri të piktuuar. Tavani i të tre nefeve ndodhet në të njëjtin nivel dhe mbështetet drejtpërsëdrejti në shtyllat apo në trarët gjatësorë që i lidhin ato.

Në krahun lindor pjesa e altarit ndahesh nga pjesa tjeter e naosit me një ikonostas druri prej të cilit kishte ngelur vetëm struktura mbajtëse prej druri duke qënë se ikonostasi është hequr. Pjesa e altarit është në nivel me të ngritur se pjesa tjeter e kishës (9 cm), ajo përbëhet nga bema me absidën gjysmërrethore, protezisi me dy nikel dhe një kamare dhe diakonikoni. E gjithë hapësira e brëndshme e nasosit është e mbuluar me pikturë murale (afresk). Kolonat dhe tavani janë gjithashu të piktuuar duke bërë që të formohet një hapësirë unike.



Teknikat e Ndërtimit: Kisha është e ndërtuar me muraturë guri të paskuadruar të vendosur në rreshta me tendencë horizontaliteti. Janë përdorur gurë gëlqeror dhe gurë shtufi të lidhur më llaç gëlqereje. Vendosja me rreshta horizontalë të gurëve në muraturë nuk është patur si qëllim gjatë ndërtimit, megjithatë vërehen here pas here rreshta gurësh të vegjël të vendosura horizontalisht me qëllim nivelimin e muraturës dhe mbatjen e drejtimit. Muratura është e përbërë nga dy paret e jatshtme dhe me mbushje në mes. Nuk dallohen prezenca e brezave të drurit nga jashtë përveçse në muret e brëndshme të ambjentit të shërbimit në krahun jugperendimor. Qoshet e mureve dhe paturat e dritareve dhe dyerive janë punuar me kujdes. Për to janë zgjedhur gurë ose blloqe gurësh më të mëdhej të cilët dhe janë skuadruar sipas rastit. Për ndërtimin e absidës janë përdorur gurë të gdhëndur dhe pjesërisht tulla. Harkada e portikut në krahun jugor është ndërtuar me kolona guri dhe tulla.




Foto 2: Foto të kishës para djegies




Foto 3: Foto të kishës pas djegies

3. PROBLEMATIKA:

Për shkak të zjarrit që u shkaktua në kishën e "Ungjillizimit" në Kozare fatkeqësisht shkaktoi dëme te mëdha në këtë monument kulture kategoria e parë. E gjithë lënda prej druri që ndodhej brenda naosit u dogj e gjitha duke përfshire stolat, kolonat (që ndanin naosin në tre nefë), skeletin e ikonostasit dhe tavanin e piktuar. Çatia e naosit u dogj e gjitha dhe rënia e saj dëmtoi edhe dyshemenë me pllaka të një faze me të vonë. Afresku e humbi ngjyrën origjinale dhe pjesë të shumta u rrëzuan.




Foto 4 : Gjëndja ekzistuese e kishës

4. NDËRHYRJET E RESTAURIMIT

A. NDËRHYRJET KONSERVUESE RESTAURUESE NDËR VITE

Duke u mbështetur në materialet e gjetura në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, del në pah se Kisha e Kozares I është nënshtruar disa ndërhyrjeve të rëndësishme restauruese.

1962-1963 – Ndërhyrja më madhore dhe njëkohësisht më e hershmja e dokumentuar në arkivin e IMK’së është restaurimi I realizuar në vitet 1962-1963 (para krijimit të IMK). Nga fotot e arkivit (të paraqitura këtu) vërehet qartë shkalla e lartë e dëmtimit të strukturave të kishës. Janë të shkatëruara paretet e jashtëme të naosit në murin lindor (absida) dhe frontoni I çatisë si edhe muri verior. Catia e naosit gjithashtu edhe ajo e hajateve duket shume e dëmtuar dhe si rrjedhojë e lageshtisë janë dëmtuar edhe muret. Pra në këto vite është realizuar një ndërhyrje madhore restaurimi për t’u lavdëruar pasi është bërë e mundur që të restaurohej e gjithë struktura e mureve si edhe catia, pa dëmtuar afreskun që mbulon hapësirën e brenshme të naosit.

Vitet 1970 – Është ndërtuar një kontrafort në qoshen verilindore të naosit dhe janë kryer punime të tjera mirëmbajtjeje.

Viti 2005 – Është realizuar përforcimi I themeleve në faqen lindore me buto beton. Është restauruar e gjithë catia e naosit dhe hajateve pasi ishte shumë e dëmtuar. Është realizuar një brez betoni në kreun e mureve verior dhe jugor dhe janë vendosur pesë tiranta metalike mbi ketë brez. Është realizuar një brez betoni në kreun e murit të hajatit jugor dhe janë vendosur disa tirante metalike që inkastrohen në brezin e betonit dhe në sofatin e hajatit për të përforcuar harkadën e hajatit. Gjithashtu në këtë hajat janë vendosur disa pajanta druri për të mbajtur murin jugor të naosit I cili paraqet levizje nga vertikaliteti. Është realizuar injektimi I të gjitha çarjeve që paraqesin fasdat (muri lindor I naosit, muri verior I hajatit, muri perëndimor I hajatit).


Viti 2008 – Është realizuar pjesërisht restaurimi I tavanit të dekoruar I cili paraqitej I dëmtuar si pasojë e lagështirës që hynte nga catia. Është bërë plotësimi I pjesëvë të munguara dhe restaurimi I atyre egzistuese.

B. NDËRHYRJET RESTAURUESE

Duke pasur parasysh atë qe ky monument përfaqëson me deshirën për të ruajtur dhe konservuar sa më shumë elementë të cilët janë ende prezentë por të rrezikuar nga gjendja e monumentit (aktualisht naosi nuk ka cati) propozojmë të bëjmë mbulimin e hapësirës së naosit me një mbulesë të tipit me kapriatë metalike.

Kapriata do te mbështetet në kolona metalike me seksion dopio T të cilat do të kenë të njëjten vendodhje ku ishin kolonat e drurit. Kapriata nuk do të mbështetet në murret e naosit por do të qëndroje konsol mbi to. Në këtë menyrë do të ruhet fizionomia dhe morfollogjia e çatisë prej druri por pa i dhënë ngarkesë mureve të naosit të cilët nuk janë në gjëndje të mirë konstruktive. Mbi kapriatë duke u mbështetur në elementët gjatësor të saj do të hidhen trarët prej druri (në drejtim tërthor) të cilët do të shërbejnë per të mbështetur petavrat. Qeramosja do të bëhet më tjegulla vendi mbi shtresën hidroizoluese që do te vendoset mbi petavra. Ne fund të ndërhyrjes ajo qe do të vihet re në eksterier do të jete siluëta e catise e cila ruan siluetën e çatisë së djegur. Kapriata do

te ketë në perberje dy kapriata kryesore gjatësore dhe katër kapriata kryesore tërthore. Në interier elementët metalik do jene të dukshem, por në një fazë tjetër ndërhyrjesh kolonat mund te maskohen me elementë prej druri dhe në kuotën ku më parë ka qenë tavani i piktuar mund të ndertohet një tavan prej druri i cili do jete në harmoni me elemenët e tjera. Mbulimi i emergjent i naosit, më shumë, do ti shërbente afreskut që ka mbetur i dëmtuar në muret e tij. Ai do të ndihmonte që mos të përkeqësesh akoma më shume gjendja si pasoje e agjentëve atmosferikë. Gjithmone duke pasur si qellim vetëm ruajtjen dhe konservimin e vlerave te ketij monumenti theksojme se kjo është zgjidhja më e përshtatëshe në këtë situatë. Do të behët forcimi i themeleve për shkak të zjarrit muret e kanë humbur fortësinë e tyre dhe materialin lidhës. Më pas do të behët fortësimi i murit të gurit të kishës me teknika të ndryshme të paraqitura në preventiv dhe ne projekt. Gjithashtu do të behët konsolidimi i kreut të sipërm të murit me 1-2 rreshta gurë. Do të behët shtrimi me pllaka e pjesës së naosit dhe shtrimi me tulla të plota e pjesës së hajatit. Do të bëhet gjithashtu dhe restaurimi i këmbanores sic eshte paraqitur dhe ne projekt.



NDËRHYRJET RESTAURESE

LEGJENDA:




- Ndertim i qatis se naosit e me strukture metallike, petava derrase e mbuluar me tjequlla vendi
- Konsolidimi i kreut te murit me 1-2 rreshta guri me lloj gilqere 1:3
- Qeramike e catise se hajati
- F.V. detari druri
- Zberimi dhe Restaurimi i çarjeve ne murin guri
- Restaurimi i gëmësive me tulla

**PAMJA ME ORIENTIM LINDOR
NDËRHYRJET RESTAURESE**

NDËRHYRJET RESTAURESE

LEGJENDA:

- Ndertim i qatis se naosit e me strukture metallike, petava derrase e mbuluar me tjequlla vendi
- Konsolidimi i kreut te murit me 1-2 rreshta guri me lloj gilqere 1:3
- Qeramike e catise se hajati
- Zberimi dhe Restaurimi i çarjeve ne murin guri
- Restaurimi i këmbanores



Përgatiti:

Ing. Eriseld ZYKA

Dhimitra
q

Digitaly signed by
Dhimitraq Niko
Date: 2023.03.30
14:32:53 +02'00'

10

